



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** më datë **03.11.2022** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Konfiskimin e pasurive të paluajtshme në zotërim të shtetasit **Shkëlzen Selimi**; persona të lidhur: K.S, R.S”. Baza ligjore, ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, me vendimin nr. **14**, datë **22.09.2026**, vendosi:

I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Revokimin e masës së sekuestros, të vendosur me vendimin nr. 10, datë 23.04.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të mosplotësimit të kushteve ligjore për vazhdimin e saj mbi pasuritë objekt të këtij gjykimi, si më poshtë:

1. ½ e pasurisë me nr. ****, volumi ****, faqe ****, zona kadastrale ****, me vendndodhje ****, adresë lagjia ****, në pronësi të shtetasit **Shkëlzen Selimi**.
2. Pasuria me nr. ****, zona kadastrale ****, e regjistruar në volum ****, faqe ****, truall me sipërfaqe 2400 m2, adresa e pasurisë **** (pasuri e përbërë nga bashkim pasurie) në pronësi të shtetasit K.S.
3. 55% e pasurisë me nr. ****, zona kadastrale ****, regjistruar në volum ****, faqe ****, e llojit truall me sipërfaqe 764 m2 dhe godinë me sipërfaqe 57 m2, adresa e pasurisë ****, pronësi e fituar me kontratën nr. **** rep., nr. **** kol., datë 15.6.2017, paguar në këtë datë vlera 40,000 euro, në pronësi të shtetasit K.S (përcaktuar pjesët takuese midis bashkëpronarëve me urdhrin nr. ****, të muajit gusht 2018).

II. Ky vendim t’i përcillet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, e cila njofton pronarin e pasurive të sekuestruara dhe vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara.

III. Shpenzimet gjyqësore sikurse janë bërë.

IV. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 22.09.2026

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar